Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

KKRF - Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar
KSFI - Kosovski Savet za Financijko Izveštavanje
KCFR - Kosovo Financial Reporting Council

Në mbështetje të Nenit 17, pika 3 dhe 4, të Ligjit Nr. 04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar (KKRF) nxjerrë:

- Udhëzues 02/2016 -

Përgatitja, Auditimi dhe Publikimi i Pasqyrave Financiare të Ndërmarrjeve në Kosovë

Neni 1 – Hyrje

1. Kërkesat për përgatitjen, auditimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare (*tash e tutje 'ndërmarrje'*) në Kosovë janë paraparë në nenet 3, 4, 5, 9 dhe 11 të *Ligjit Nr. 04/L-014 'Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim'* (*tash e tutje 'Ligji'*). Qëllimi i këtij udhezuesi është që të sqaroj të gjitha kërkesat dhe obligimet mbi përgatitjen, auditimin dhe publikimin e pasqyrave financiare të secilës kategori të ndërmarrjeve të klasifikuara në nenin 4 të Ligjit.

Neni 2 – Definimi i ndërmarrjeve

1. Definicioni i ndërmarrjeve për qëllime të interpretimit të ligjit është dhënë në nenin 2, pika 1.7 '*Shoqëri Tregtare - çfarëdo lloji i shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare*'. Termi shoqëri tregtare, sipas *Ligjit Nr. 02/L-123 'Për Shoqëritë Tregtare'* është term i përgjithshëm dhe përfshin çfarëdo lloji të ndërmarrjes të themeluar në Kosovë përfshirë *Bizneset individuale ('BI'), ortakëritë ('O'), shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara ('SHPK'), shoqëritë aksionare ('SHA')* dhe llojet e tjera të lejuara me ligjin mbi shoqëritë tregtare.

2. Neni 4 i ligjit i përcakton kriteret se si një ndërmarrje mund të klasifikohet si e madhe, e mesme, e vogël, apo mikro-ndërmarrje, pavarësisht a është e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI) si 'BI', 'O', 'SHPK', 'SHA' apo formë tjetër të lejuar të ndërmarrjes.